



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:076046  
Datë: 21.02.2024  
Numri i dokumentit: 05353886

Pml.nr.74/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit F. K., për shkak të veprës penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të Kodit Penal të republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë P.nr.60/2021 të datës 12.07.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1298/2022 të datës 25.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 shkurt 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit F. K. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë P.nr.60/2021 të datës 12.07.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1298/2022 të datës 25.09.2023.

**A r s y e t i m**

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.60/2021 e datës 12.07.2022, të dënuarin F. K. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK-së duke e ka gjykuar me dënim me gjobë në lartësi prej ... €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej... €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej ... € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të kimit, kurse të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1298/2022 e datës 25.09.2023, ka refuzuar si të bazuar ankesën e të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse e ka hudhur si të palejuar ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

## **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.43/2024 e datës 02.02.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

## **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë i dënuari thekson faktin se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në atë mënyrë që nuk janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i konsideron që kanë vërtetuar fajësinë e të dënuarit, me ç'rast nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësisë së tij penale.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve duke mos u besuar deklarimeve të dëshmitarëve dhe të cilat deklarime i ka konsideruar si jo bindëse, kundërthënëse dhe me qëllim të shmangies nga e vërteta dhe shfajësimi i kolegut të tyre. Meqë nga dëshmitë e dëshmitarëve okular të njëjtit kanë mohuar faktin se i dënuari e kishte goditur të dëmtuarin dhe gjithashtu të njëjtit kishin dëshmuar lidhur me sjelljet e këqija dhe rezistencën e të dëmtuarit me rastin e arrestimit dhe si pasojë e kësaj rezistence kishte ardhur edhe deri te rrëzimi i tij dhe lëndimi i pësuar në kokë. Gjithashtu edhe mbrojtja e të dënuarit nuk është çmuar meqë i njëjti ka deklaruar se ka vepruar në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tij duke zbatuar urdhra të ligjshëm nga mbikëqyrësit e tij të cilët kishin urdhra për të kufizuar lirinë e lëvizjes dhe mbajtjen e maskave sipas udhëzimeve të IKSHP.

Tutje pretendohet se edhe provat tjera janë interpretuar në mënyrë të gabuar dhe atë ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor, me ç'rast është konstatuar se i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, mirëpo ekspertiza nuk e përcakton se në çfarë mënyre janë shkaktuar lëndimet trupore si pasojë e përdorimit të forcës nga ana e zyrtarit policor- të dënuarit apo si pasojë e lëndimit të të dëmtuarit gjatë rrëzimit të tij në tokë me rastin e vendosjes së prangave. Gjithashtu edhe përkitazi me video incizimin pretendohet se është ardhë deri te përfundim i gabuar, meqë nga shikimi në videoincizim nuk vërtetohet fakti se i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është gjykuar.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave kanë parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e theksuara në kërkesë përkitazi me faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të qartë provat e administruara, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës del se pretendimi nuk është i bazuar, meqë nga përmbajtja e arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rrjedh se janë vlerësuar të gjitha provat e administruara. Për më tepër, për secilën provë të administruar është paraqitur arsyetim i qartë dhe i plotë duke filluar nga dëshmitë e dëshmitarëve, ekspertiza mjeko-ligjore, videoincizimet, si dhe vet mbrojtja e të dënuarit, me ç'rast është ardhur në përfundim se në veprimet e të dënuarit janë realizuar elementet e veprës penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK-së. Përtej kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore kanë vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë, andaj gjetjet dhe konkludimet e këtyre gjykatave i mbështetë në tërësi edhe kjo gjykatë.

Pretendimet përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht faktin se ekspertiza mjeko-ligjore nuk ka përcaktuar mënyrën e shkaktimit të lëndimit trupor dhe se deri te lëndimi trupor ka ardhur me rastin e prangosjes së tij, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në këtë çështje penale të dy gjykata e instancave më të ulëta gjyqësore kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm edhe përkitazi me natyrën, llojin e po ashtu edhe mënyrën e lëndimit trupor lëndimit të pësuar nga ana e të dëmtuarit. Mirëpo përtej kësaj, i rëndësishëm është të theksohet fakti se për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar, përkatësisht për veprën penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par.1 të KPRK-së nuk është vendimtar fakti i lëndimit trupor i pësuar nga ana e të dëmtuarit. Meqë, vepra penale mund të realizohet edhe pa shkaktimin e lëndimit trupor dhe atë duke pasur parasysh inkriminimin ligjor të veprës penale nga neni 195 par.1 të KPRK-së, me ç'rast është përcaktuar se: “ *Personi zyrtar, i cili duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij e keqtrajton, frikëson ose fyen rëndë dinjitetin e personit tjetër...*”. Kurse në rastin konkret duke u bazuar në shkresat e lëndës del se kjo vepër penale nga ana e personit zyrtar realizohet përmes keqpërdorimit të detyrës apo autorizimit dhe duke keqtrajtuar, frikësuar apo fyen rëndë dinjitetin e personit tjetër, pra nuk është e domosdoshme që keqtrajtimi të realizohet përmes lëndimit trupor, siç pa bazë pretendohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se përkundër faktit se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur

pretendime përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.74/2024, më 13 shkurt 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi